

**Z. Benard Haka** ka mbaruar studimet Bachelor pranë Universitetit Politeknik të Tiranës, në vitin 2012, i diplomuar në Inxhinieri Telekomunikacioni. Ndërsa studimet Master i Shkencave i ka mbaruar pranë Universitetit European të Tiranës, i diplomuar në Informatikë Ekonomike. Gjithashtu, po pranë Universitetit European të Tiranës ka mbaruar dhe Masterin Profesional, i diplomuar për Informatikë të Aplikuar.

Z. Haka gëzon një eksperiencë administrative mbi 7 vjeçare në fushën e auditimit të jashtëm publik, si dhe një eksperiencë të mëparshme në sektorin privat, ku ka qenë i angazhuar në pozicione të ndryshme në fushën e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Në vitet 2018-2019, Z. Haka ka ndjekur për një periudhë 5 mujore, programin e “Internship”-it në Gjykatën Evropiane të Audituesve (ECA), në Luksemburg, ku ka qenë pjesë e Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë së Auditimit (Directorate of Audit Quality Control, DQC).

Gjithashtu Z. Haka ka marrë pjesë aktive dhe ka qenë pjesë e grupit të punës IT të EUROSAIT, ITWG mbi platformën CUBE (Control Space for e-Government), Hapësirën e Kontrollit të e-Qeverisjes dhe projekti mbi Manualin Aktiv të Teknologjisë së Informacionit (AITAM), si dhe projektet mbi Vetëvlerësimin e Teknologjisë së Informacionit dhe Vetëvlerësimin të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit.

Gjatë karrierës së tij profesionale ka marrë pjesë në aktivitete të ndryshme institucionale kombëtare dhe ndërkombëtare, në trajnime, kongrese, konferenca, seminare, workshop-e të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, në lidhje me çështje të auditimit IT, të llogaridhënies, të auditimit të jashtëm publik dhe institucioneve supreme të auditimit. Z. Haka, ka dhënë kontributin e tij në botime të ndryshme në KLSH, artikuj në gazeta e revista si dhe përkthime të ndryshme etj.

Prej vitit 2014, ai ka ushtruar pozicionin e audituesit, e më pas të kryeaudituesit në departamente auditimi dhe aktualisht është pjesë e Departamentit të Auditimit të Teknologjisë së Informacionit, ku dhe mban pozicionin e Kryeaudituesit të këtij departamenti.

Z. Haka është njohës shumë i mirë i gjuhës angleze dhe italiane.